



DEKLARATË E PËRBASHKËT PUBLIKE

Kërkesat e Forumit Ekonomik të Grave që reformat ekonomike dhe sociale të përfshihen në programet e të gjitha partive politike.

PRISHTINË, Kosovë — Forumi Ekonomik i Grave i drejtohet me këtë letër të hapur të gjitha partive politike që garojnë në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 7 qershorit 2026, duke u bërë thirrje që në programet e tyre të përfshijnë zotime konkrete për barazi gjinore ekonomike, për të siguruar:

1. Të miratohet një ligj i ri për punën.

Ligji aktual, i cili është në rishikim prej më shumë se tetë vitesh, [kontribuon në diskriminimin ndaj grave në punësim](#). Ligji aktual i punës kërkon një reformë më të gjerë për të adresuar disavantazhet strukturore që hasin gratë në tregun e punës. Një prioritet është përafrimi i dispozitave për lejen prindërore me Direktivën e BE-së mbi Balancën Punë Jete (2019/1158). [Rritja e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore](#) jo vetëm që do të rriste ndjeshëm Bruto Produktin Vendor (BPV), por gjithashtu do të përmirësonte të ardhurat e familjeve dhe qëndrueshmërinë sociale. Gjithashtu, ligji duhet të forcojë në mënyrë të qartë dhe efektive mekanizmat e mbrojtjes së grave nga diskriminimi në punësim, largimi nga puna gjatë shtatzënisë dhe format e tjera të pasigurisë në vendin e punës.¹

2. Investoni në shërbim e kujdesit.

Mungesa e shërbimeve të përballueshme dhe të qasshme për kujdesin ndaj fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara dhe kujdes për personat me sëmundje, mbeten një nga barrierat kryesore për punësimin e grave. [Investimi në një rrjet kombëtar të kujdesit](#) dhe lehtësimi të pagesave të kopshteve për edukim të fëmijëve mund të krijojë mbi [22,000 vende formale pune](#). Kjo do të rriste pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, transformim të punës së papaguar dhe uljes së informalitetit.

3. Institucionalizimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.

Megjithëse qeveria është zotuar për buxhetim të përgjegjshëm gjinor (BPGj), [zbatimi i tij është vonuar](#). Ne i bëjmë thirrje qeverisë që të institucionalizojë BPGj-në duke ndryshuar Ligjin për Financa Publike dhe Ligjin për Prokurime Publike, ndër të tjera, si të bëjë gati dhe të publikojë rregullisht shtojcat e BPGj-së që kërkohen nga qarkoret buxhetore.

4. Krijoni një grant specifik për financimin e shërbimeve sociale.

¹ Projekti "Më shumë zgjedhje" mbështetur nga UNFPA ka kontribuar në ngritjen e vetëdijes përmes raporteve dhe analizave lidhur me Direktivën e BE-së mbi Balancën Punë Jete (2019/1158).

Shërbime sociale në Kosovë përballen me buxhet të pamjaftueshëm dhe të bazuar në nevoja. Bëjmë thirrje që Qeveria duhet të sigurojë zbatimin e plotë të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, si dhe të krijoj një Grant Specifik për financim e shërbimeve sociale dhe Qendrave për Punë Social-ve. Kjo do të siguronte shërbime kualitative për gratë që përjetojnë dhunë, fëmijët në nevojë, nënat vetushqyese, personat me aftësi të kufizuar, dhe të gjithë përfituesit e shërbimeve sociale. Mbështetja financiare për të gjitha këto kategori duhet të bëhet duke zbatuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

5. Rritni fondet për të mbështetur gratë në biznes dhe organizatat që punojnë për barazi ekonomike të grave.

Kjo duhet të reflektohet përmes politikave konkrete që lehtësojnë qasjen në financa, qasjen në pronë, të përshpejtojnë digjitalizimin përmes subvencioneve, trajnimeve dhe zhvillimit për rritjen e tyre, plotësimin e standardeve dhe certifikimin e produkteve. Këto politika të kontribuonin drejtpërdrejt në rritjen e konkurrueshmërisë, zgjerimin e qasjes në tregje dhe pjesëmarrjen e barabartë të grave në zhvillimin ekonomik të vendit. [Hulumtimet tregojnë se](#) është e rëndësishme të adresohen barrierat konkrete që vazhdojnë të kufizojnë gratë ndërmarrëse, përfshirë qasjen në financa, prona, subvencione dhe mundësi të barabarta zhvillimi ekonomik.

Në të njëjtën kohë, në një kontekst të krizës globale në mbështetje të të drejtave të grave, u bëjmë thirrje partive politike që në qeverinë dhe kuvendin e ardhshëm të dëshmojnë angazhim konkret për barazinë gjinore përmes ndarjes së [fondeve të dedikuara për organizatat që punojnë në këtë fushë](#), përmes Agjencisë për Barazi Gjinore. [Hulumtimet tregojnë se](#) ky financim duhet të jetë afatgjatë (së paku dyvjeçar) dhe i mjaftueshëm për të mundësuar ndryshime me ndikim të qëndrueshëm.

Financimi duhet të dizajnohet në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe të shpërndahet përmes një mekanizmi të pavarur, në mënyrë që të shmanget politizimi dhe të sigurohet transparencë dhe efektivitet bazuar në Programin për Barazi Gjinore dhe evitim të dublikimit të projekteve.

Pa fuqizimin e grave, nuk ka zhvillim.

Ne mbetemi të gatshëm të angazhohemi me të gjitha partitë politike dhe institucionet relevante për avancimin e këtyre prioritetëve. Le të punojmë së bashku, politikëbërës dhe shoqëri civile, për të sjellë zgjidhje dhe mundësi për kujdes cilësor social dhe qasje të barabartë në tregun e punës për gratë dhe burrat e Kosovës.

Forumi Ekonomik i Grave është koalicion i organizatave të shoqërisë civile me këtë përbërje:

Instituti Riinvest;

Rrjeti i Grave të Kosovës (103 organizata anëtare);

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D);

Qendra Kosovare për Studime Gjinore;

Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase;

Kosova – Women 4 Women; Insituti GAP,

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS),

Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion (QIKA)